

KONTRATË SHITJE KUOTASH

E lidhur në Tiranë, sot më 10/02/2020, ndermjet paleve si me poshte vijon:

Znj. Anisa Hyseni, atesia Faik, i dtl. 23.11.1989, lindur ne Tepelene, Shqiperi, dhe banuese ne Rr. Margarita Tutulani, Tirane, shtetase shqiptare, madhore, me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i kartes me nr. I96123017D, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, ketu e me poshte si SHITESI,

dhe

Z.Ardi Dervishi, atesia Emin, i dtl. 25.10.1972, lindur ne Durres, Shqiperi, dhe banuese ne Rrugen:Sami Frasheri,Pallati1, Ap.7 Tirane, shtetase shqiptare, madhore, me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i karte me nr. **H21025017J**, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar ketu e me poshte I njohur si BLERESI,

MEQENESE:

A.Shitësi zoteron 1% të Kapitalit te Shoqërisë “ERMED” Sh.p.k, ME VLERE 30.000 ALL, nje shoqeri e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës se Shqipërise, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me L 51708026 D, me seli ne adresen: Rruga “ 3 Deshmoret, Zona Kadastrale 8240, Nr.Pasurie 2/312 (me poshte referuar si “Shoqeria”):

B.Shitesi deshiron t’I shese Bleresit dhe Bleresi deshiron te blej nga Shitesi 1% te kapitalit te zotuar nga Shitesi ne Shoqerine e lartpermendur.

C. Në perputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, I ndryshuar, si dhe me vendimin bashkëlidhur te Ortakevet te shoqerise, per shitjen e kuotave te shoqerise, Palet deshirojne te lidhin kete Kontrate.

PER SA ME SIPER, palët bien dakord si vijon:

- 1.Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Shitesi I shet Bleresit dhe Bleresit blejne nga Shitesi 1% te kuotave te kapitalit te Shoqerise “ ERMED” Sh.p.k.
 - 2.Transferimi I pronësisë mbi kuotat dhe regjistrimi I transferimit behet menjëherëme nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe pavarësisht mënyrës se pagimit te cmimit te shitjes te përcaktuar këtu.
 - 3.Cmimi I shitjes se kuotave, ne vlerën e përgjithsme të rënë dakord prej 30.000 Leke. Cdo pagese qe perben pjese te cmimit te shitjes sipas kesaj kontrate ne favor te shitesit, do te behet ne llogarine bankare te shitesit prane BKT.
- Palet deklarojne e garantojne reciprokisht njera-tjetren se cmimi I shitjes se kuotave eshte drejte, I arsyeshem dhe I caktuar me vullnetin e lire e te plote te paleve.

4. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësit se pjeset e kapitalit të transferuara këtu, janë në pronësinë e tij të plotë e ligjore dhe të lira nga barra hipoteke apo pengje.

5. Blerësit pranojnë pronësinë e kuotave, 1% të kapitalit të Shoqërisë, duke njohur gjendjen e Shoqërisë dhe bien dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i kuotave brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar. Me nënshkrimin e kësaj kontrate Blerësi dhe Shitësi bëhet zotëruar :

Z. Ardi Dervishi, është zotëruar i 1 kuote me vlerë 3.000.000 leke, e cila përfaqëson 100 % të kapitalit themelues të shoqërisë dhe:

6. Në rast se Blerësi, Brenda një periudhe një vjeçare nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate, deshton në shlyerjen e plotë të pagesës së vlerës së plotë të kuotave, atëherë Shitësit i lind e drejta e rimarrjes 1% të kuotave të Shoqërisë.

7. Blerësi merr përsipër pagesën e detyrimeve tatimore që lindin nga realizimi i këtij transaksioni lidhur me Tatimin në Burim, për fitimin e realizuar nga shitja e kuotave.

8. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parëtë palet tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të kuotave objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare e Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër Shqiptar sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Kjo Kontrate u hartua në 4 (katër) origjinale në gjuhën Shqipe. Kontrata bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Nr.9901, Date 14.04.2008. Marrëveshja pasi u lexua prej palëve, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre.

PALET

SHITESI

Anisa Hyseni

BLERESIT

Ardi Dervishi